

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Romero te Huijsen, Real Madridi denoncon vendimet e arbitrit pas humbjes ndaj Atlético Madridit
ADRESA	https://albeu.com/sport/nga-romero-te-huijsen-real-madridi-denoncon-vendimet-e-arbitrimi-t-pas-humbjes-ndaj-atletico-madridit/1020365/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 20:13:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 20:07:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d1f8ed8e32776fc743c474c770c9b92967382f50c1a9c8f5ad515e3f676d05
TEKSTI	58b9117b2e4e15565bdc3381afce923574d850dc9752d1dab10ea701dbd98a59
PAMJA	2d2405dfa8048e17bed7ae12b03f668a3677731f4c87b4f2a0839740bc0f6ec0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6619c44732fecc94ba634c0f94cef4043706df6504876a249786c032c6092616
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d6a36024fef06cd2a7915f3a91ac1ec4390e61f25659ece2cd1751f77a3cac08
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6619c44732fecc94ba634c0f94cef4043706df6504876a249786c032c6092616>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga Romero te Huijsen, Real Madridi denoncon vendimet e arbitrimnit pas humbjes ndaj Atlético Madridit



Humbja 2-1 ndaj Atlético Madridit në derbin e luajtur në "Metropolitano" ka shkaktuar reagim të fortë nga Real Madridi, i cili ka kritikuar publikisht gjyqtarin Ortiz Arias dhe ekipin e VAR-it.

Klubi madrilen publikoi raportin zyrtar të ndeshjes nën titullin "Gjykim i dëshpëruar vendosi derbin", duke argumentuar se disa vendime të arbitrave patën ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe rezultatin e takimit.

Një nga rastet e përmendura nga Real Madridi ndodhi në minutën e 35-të, gjatë një dueli mes Cristian Romero dhe Jude Bellinghamit. Romero e goditi me gju mesfushorin anglez, por Ortiz Arias i akordoi fillimisht karton të verdhë Bellinghamit. Pas ndërhyrjes së VAR-it, arbitri e anuloi kartonin e lojtarit të Realit, ndërsa Romero nuk u ndëshkua me përjashtim.

Real Madridi rikthen në vëmendje edhe një episod tjetër të pjesës së parë. Kang-in Lee shkeli në kyçin e këmbës së Federico Valverdes, por megjithatë Ortiz Arias ndodhej pranë aksionit, nuk dha karton. Në këtë rast nuk pati as ndërhyrje nga VAR-i, çka sipas klubit përbën një tjetër vendim që mund të kishte ndikuar në vazhdimin e ndeshjes.

Megjithatë, pakënaqësia më e madhe e klubit lidhet me ngjarjen e minutës së 50-të. Pas ndërhyrjes së Dean Huijsen ndaj Giuliano Simeones, Ortiz Arias akordoi penallti për Atlético Madridin dhe e ndëshkoi fillimisht mbrojtësin e Realit me karton të verdhë. Pas sinjalizimit nga VAR-i, gjyqtari rishikoi pamjet dhe e zëvendësoi vendimin me karton të kuq.

Alejandro Grimaldo realizoi nga pika e bardhë, duke e çuar rezultatin në 1-0. Atlético Madrid më pas përfitoi nga avantazhi numerik për të marrë kontrollin e derbit. Sipas Real Madridit, thelbi i ankesës qëndron te fakti se rastet e Romero dhe Kang-in Lee nuk u gjykuan me të njëjtin standard si ndërhyrja e Huijsenit.

të fundit /



Belgjika i kushton një ditë rrugëve pa automjete



Hyundai paralajmëron për ndikimin e mundshëm të makina...



Protesta në Tiranë, marshuesit ndalen para Ministrisë së...



Analisti paralajmëron: Kërkesa për shpërbërjen e Gjykat...



Përfundon votimi parlamentar në Rusi, Putin pritet të forcojë...



Protestuesit mbledhen për të pestën natë në Prishtinë kundër...



E mbajti të fshehtë, moderatorja e njohur shqiptare do të bëhet...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Të dy vendimet shënuan ndeshjen", thuhet në një nga vlerësimet kryesore të raportit zyrtar të klubit, i cili e paraqet arbitrimin si një faktor me ndikim në disfatën e pësuar në "Metropolitano".

Edhe trajneri José Mourinho shprehu kritika pas përfundimit të ndeshjes. Portugezi vuri në diskutim vendimet e Ortiz Arias dhe të gjyqtarit të VAR-it, Trujillo Suárez, duke ngritur dyshime për kriterin e ndjekur në episodet e kontestuara.

Atlético Madrid e mbylli derbin me fitoren 2-1, ndërsa në kampin madrilen vëmendja pas ndeshjes u përqendrua jo vetëm te rezultati, por edhe te vendimet e arbitrimin që Real Madridi i cilëson të diskutueshme dhe me ndikim në rrjedhën e takimit.

Shtuar më 20.09.2026 22:07

Tags: [Atletico Madrid](#), [la liga](#), [real madrid](#)



Drita merr tri pikë në Klinë, Dukagjini ndalet nga shtylla në shtesë



Drenica inauguron reflektorët në "Bajram Aliu" me triumf të thellë 4-0 nd...




Karim Loukili pas fitores ndaj Partizanit: Dua të ndihmoj Egnatian me gol...



Egnatia mposht Partizanin, Nevil Dede mungon para mediave; zyrtari Karafici...



Vëllaznimi ndahet nga Leotrim Krasniqi pas tri fitoreve dhe tri humbjeve



Partizani vijon rezultatet negative, Florin Bratu pas disfatës në Rrogozhinë: ...



Juventusit mposht Atalantën 2-0, Zhegrova asiston në fitoren e bardhezinjve



Cunha i siguron Manchester Unitedit barazimin në fund ndaj...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliqaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com